



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2007 Prot.

Korçë, më 25.11.2019

VENDIM

Nr. 626, datë 25.11.2019

PËR

**PËRCAKTIMIN E NUMRIT MAKSIMAL TË ORËVE SUPLEMENTARE
JASHTË AUDITORIT, QË PAGUHEN, REFERUAR PËRCAKTIMEVE TË
UDHËZIMIT NR. 29, DATË 10.09.2018, "PËR VEPRIMTARINË DHE
NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR**

Senati Akademik, i mbledhur në datën 25/11/2019, pasi u njoh dhe diskutoi në lidhje me kërkesën nr. 2007 prot., datë 25/11/2019, të Rektoratit, për përcaktimin e numrit maksimal të orëve suplementare *jashtë auditorit*, të cilat mund të paguhen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë», Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, kreu II, pika 1 dhe kreu III, pika 2, si dhe në kërkesën nr. 2007 prot., datë 25/11/2019, të Rektoratit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën nr. 2007 prot., datë 25/11/2019, "Kërkesë për përcaktimin e numrit maksimal të orëve suplementare jashtë auditorit, të cilat paguhen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar", të Rektoratit të Universitetit.
2. Numri maksimal i orëve suplementare *jashtë auditorit*, të cilat paguhen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, kreu II, pika 1 dhe kreu III, pika 2, të jetë deri në 100 orë.

3. Ky vendim t'i përcillet Bordit të Administrimit për miratim të mëtejshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. dr. Ali Jashari

